



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 552/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Gjilan, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dhe komisionerve në vendvotim dega në Gjilan, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si të pabazuar ankesat e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partis (KTAP), dega në Gjilan: Anr.552/2013, dhe Anr.553/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr.552/2013 dhe Anr.553/2013, nga KTAP dega në Gjilan me të cilat pretendohet se gjatë ditës së votimit ka pasur parregullsi të natyrave të ndryshme si manipulim të votave.

- Sipas ankesë Anr 552/2013, pretendohet se në Qendrën e Votimit nr.0402D/07R në shkollën "Selami Hallaqi" kanë gjetur parregullsi si në vijim: Votues të regjistruar 819, Numri i nënshkrimeve në LPV 563, Numri i fletvotimev të vlefshme 502, Numri i fetvotimeve të pavlefshme 61, pasi numërimit të votave del se në kuti janë 700 vota. Në pretendimet e ankuesit thuhet se 200 vota janë më shumë se që ka nënshkrime. Ato 200 vota kanë përfunduar në Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur fotografi.

- Sipas ankesë Anr 553/2013,pretendohet se në Qendrën e Votimit nr.0402D/07R në shkollën "Selami Hallaqi" pasi që e kemi gjetur rastin e manipulimit të votave,kemi humbur besimin në numërimin që është bërë në vendvotim ashtu që kërkojmë rinumërimin e votave në të gjitha vendvotimet.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi për shkeljen e pretenduar .

Në përgjigjen e datës 07.11.2013 të ofruar në PZAP nga KQZ lidhur me pretendimet ankimore të ankusit të subjektit politik KTAP , për Qendrën e Votimit 0402D/07R lidhur me pretendimet se në kutin e votimit gjendën më shumë vota se sa nënshkrime në listen votuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ,ka njoftuar se materiali zgjedhor është duke u proceduar sipas procedurave të brendshme të QNR-së,dhe deri në përfundim të këtij procesi nuk mund të vërtetohet saktësia e pretendimeve ankimore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se.

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e subjektit politik KTAP nuk qëndrojnë ngase në shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur asnjë provë që mund të identifikohet shkelja e supozuar, si dhe nuk ka cekur kryesin e shkeljes së supozuar, për deri sa KQZ konkretisht QNR është në procedim të numërimit dhe rezultateve përfundimtare. Andaj në kuptim të nenit 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 552/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.